



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 maj 2012
Nr. ref.:AK 234/12

Rasti KO38/12

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për
Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të
Republikës më 12 prill 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Kërkesa

1. Më 28 mars 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 92.4, 93.4 dhe 9, dhe 144.1, nxori Vendimin Nr. 02/68 për miratimin e Propozimeve për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës).
2. Në përputhje me të njëjtin Vendim, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit u obligua t'ia procedonte Kuvendit të Republikës së Kosovës Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës.
3. Më 5 prill 2012, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit ia përcolli Sekretarit të Kuvendit të Kosovës Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës.

4. Më 12 prill 2012, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, në përputhje me nenin 114.3 të Kushtetutës, ia paraqiti Gjykatës Kushtetuese Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës për të vlerësuar paraprakisht nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
5. Prandaj, Kryetari i Kuvendit është parashtrues i kërkesës në procedurën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-121), të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
7. Objekt i çështjes së kërkesës janë 22 amendamentet e propozuara për Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të miratuara me Vendimin Nr. 02/68 të Qeverisë së Kosovës më 28 mars 2012.
8. Që në fillim duhet të theksohet se pjesa më e madhe e amendamenteve të propozuara kanë të bëjnë me ndryshimet brenda Kapitullit XIII “Dispozitat Përfundimtare” dhe Kapitullit XIV “Dispozitat Kalimtare” të Kushtetutës.
9. Në të vërtetë, këto amendamente shprehin synimin e Qeverisë për të propozuar ndryshime në Kushtetutë që janë të nevojshme për përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur të Republikës së Kosovës. Kjo gjithashtu shihet qartë nga preambula e Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, pasi ajo thirret në Rezolutën për Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 31 janar 2012.

Procedura në Gjykatë

10. Kryetari i Kuvendit e dorëzoi kërkesën lidhur me Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës më 12 prill 2012.
11. Më 13 prill 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.
12. Më 20 prill 2012, Kryetari i Kuvendit u njoftua se Gjykata e ka regjistruar kërkesën.
13. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Kosovës dhe Avokatit të Popullit.
14. Më 23 prill 2012, Gjykata e njoftoi Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN) se kërkesa e sipërpërmendur ishte pranuar nga Gjykata.
15. Më 2 maj 2012, Gjykata e njoftoi PCN-në se Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës kanë të bëjnë, ndër të tjera, me disa dispozita kalimtare në Kushtetutë, si dhe me autoritetin e PCN-së për të vazhduar funksionin e vet. Në atë shkresë, Gjykata theksoi se Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton që Gjykata duhet të vendosë lidhur me amendamentet e propozuara, sipas mundësisë, brenda 60 ditëve pas pranimit të kërkesës.

16. Gjykata theksoi se amendamentet propozojnë, ndër të tjera, fshirjen e neneve 146 dhe 147 të Kushtetutës, të cilët specifikojnë mandatin, kompetencat dhe obligimet e PCN-së. Gjykata gjithashtu iu referua nenit 5.2 të Aneksit IX të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (PGJZ), i cili përcakton që “Mandati i PCN-së do të skadojë atëherë kur Grupi Drejtues Ndërkombëtar të konstatojë se Kosova i ka përmbushur kushtet e kësaj zgjidhjeje”.
17. Ligji për Gjykatën Kushtetuese e obligon Gjykatën të vendosë për amendamentet e propozuara brenda 60 ditëve. Ndërkohë, Gjykata do të vazhdojë vlerësimin e vet nën arsyetimin se Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës nuk do të parashtrohen për miratim nga Kuvendi para se të jetë përmbushur kushti nga neni 5.2 i Aneksit IX të PGJZ-së lidhur me përfundimin e mandatit të PCN-së.
18. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtari raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë.
19. Gjykata u këshillua dhe votoi për këtë kërkesë më 10 maj 2012.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Sa i përket kërkesës për vlerësimin paraprak të amendamenteve të propozuara të Kushtetutës, në përputhje me nenin 144 [Amendamentimi], Gjykata vëren që, për të gjykuar për kërkesën, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse ka juridiksion për të ofruar vlerësim për Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës.
22. Gjykata rikujton që, në përputhje me nenin 113.9 të Kushtetutës, *“Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës”*.
23. Si rrjedhojë, Gjykata ka juridiksion të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara i zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.
24. Pyetja tjetër është kush mund të konsiderohet palë e autorizuar për ta parashtruar kërkesën në Gjykatë në përputhje me nenin 113.9 të Kushtetutës. Gjykata ripërsërit se në përputhje me pjesën e parë të fjalisë së nenit 113.9: *“Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara”*.
25. Në kërkesën në fjalë, Kryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, e dorëzoi kërkesën për të vlerësuar paraprakisht amendamentet e propozuara të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka të drejtë ta ngrejë këtë rast në Gjykatë sipas nenit 113.9 të Kushtetutës.
26. Prandaj, kërkesa është e pranueshme pasi Gjykata ka juridiksion për ta shqyrtuar atë dhe parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara

Shtrirja e vlerësimit kushtetues

27. Gjykata tani do ta shqyrtojë secilin amendament të përmendur në Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës dhe të dorëzuar nga parashtruesi më 12 prill 2012.
28. Si vërejtje paraprake, Gjykata thekson se në përputhje me nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese], Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Prandaj, është detyrë e Gjykatës ta interpretojë nenin 144 [Amendamentimi] të Kushtetutës siç e konsideron të nevojshëm.
29. Duke marrë këtë parasysh, Gjykata, sipas nenit 144.3 të Kushtetutës, vlerëson nëse një amendament i propozuar i Kushtetutës do të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës [Të Drejtat dhe Liritë Themelore].
30. T'i kthehemi Kapitullit II, Gjykata vëren që në përputhje me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit II, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, sipas nenit 21.2, Republikës së Kosovës i takon t'i mbrojë dhe garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në këtë Kushtetutë.
31. Prandaj, Gjykata konsideron që neni 21 përcakton shtrirjen e Kapitullit II për t'i përfshirë edhe ato të drejta dhe liri themelore të njeriut të përcaktuara gjetiu në Kushtetutë. Rezulton që Gjykata duhet të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e garantuara me Kushtetutë si tërësi.

Amendamentet e propozuara

I. Amendamenti 1 i propozuar

32. Amendamenti 1 propozon që paragrafi 4 i nenit 58 të ndryshohet si vijon:

*“Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe **pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje.** Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit”.*

33. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar për nenin 58.4 të Kushtetutës e fuqizon pjesëmarrjen efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në jetën publike.
34. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti 1 i propozuar nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

II. Amendamenti 2 i propozuar

35. Amendamenti 2 propozon që paragrafi 1 i nenit 81 të ndryshohet si vijon:

Neni 81 [Legjislacioni me Inertes Vital]

1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet **vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë .”**
36. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar për nenin 81.1 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
37. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti 2 është në përputhje me Kapitullin II.

III. Amendamenti 3 i propozuar

38. Amendamenti 3 propozon që paragrafi 5 i nenit 81 të Kushtetutës të ndryshohet si vijon:

(5) Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe **zonave të veçanta të mbrojtura.”**

39. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar për nenin 81.5 të Kushtetutës, pra shtimi i “*dhe zonave të veçanta të mbrojtura*”, nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
40. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti 3 i propozuar është në përputhje me Kapitullin II.

IV. Amendamenti 4 i propozuar

41. Amendamenti 4 propozon që neni 143 i Kushtetutës të fshihet.
42. Neni 143 i Kushtetutës thotë si vijon:

“Neni 143 [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës]

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

1. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.
3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.”

43. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 143 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

V. Amendamenti 5 i propozuar

44. Amendamenti 5 propozon që neni 144 i Kushtetutës (Amendamenti) të bartet tek Kapitulli I – Dispozitat Themelore.
45. Neni 144 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 144 [Amendamenti]

1. Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamente të kësaj Kushtetute.
 2. Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.
 3. Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
 4. Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
46. Gjykata konsideron se bartja e propozuar e nenit 144 të Kushtetutës tek Kapitulli I (Dispozitat Themelore) nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VI. Amendamenti 6 i propozuar

47. Amendamenti 6 propozon që neni 145 i Kushtetutës (Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm) të bartet tek Kapitulli I – Dispozitat Themelore.
48. Neni 145 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm]

1. Marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet e tjera për bashkëpunimin ndërkombëtarë, që janë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të vazhdojnë të respektohen deri atëherë kur ato marrëveshje ose akte të rinegociohen ose kur të bëhet tërheqja nga to në pajtueshmëri me kushtet e tyre ose deri atëherë kur ato të zëvendësohen nga marrëveshje ose akte të reja ndërkombëtare me të cilat mbulohen fushat e njëjta dhe që janë miratuar në pajtim me këtë Kushtetutë.
2. Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë.

49. Gjykata konsideron se bartja e propozuar e nenit 145 të Kushtetutës tek Kapitulli I (Dispozitat Themelore) nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VII. Amendamenti 7 i propozuar

50. Amendamenti 7 propozon që neni 146 i Kushtetutës të fshihet.
51. Neni 146 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 146 [Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

1. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil dhe organizatat e akterët e tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, kanë mandatin dhe kompetencat e përcaktuara me Propozimit Gjithëpërfshirës duke përfshirë zotësinë juridike si dhe privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara me të.
 2. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës bashkëpunojnë plotësisht me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil, organizatat dhe akterët tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007 dhe ndër të tjera i'u japin fuqi ligjore vendimeve ose akteve të tyre.
52. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 146 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VIII. Amendamenti 8 i propozuar

53. Amendamenti 8 propozon që neni 147 i Kushtetutës të fshihet.
54. Neni 147 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 147 [Autoriteti Përfundimtarë i Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil]

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti përfundimtarë në Kosovë lidhur me interpretimin e aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka juridiksion të rishikojë, të pakësojë ose në ndonjë mënyrë të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 146 dhe në këtë nen.

55. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 147 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

IX. Amendamenti 9 i propozuar

56. Amendamenti 9 propozon që neni 148 i Kushtetutës të fshihet.

57. Neni 148 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 148 [Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës]

1. Për dy (2) mandatet e para zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ketë njëzet (20) vende të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë në mënyrën si vijon: Dhjetë (10) vende do t'u ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb të Kosovës, dhe dhjetë (10) vende do t'u ndahen komuniteteve të tjera si vijon: komunitetit Rom një (1) vend; komunitetit Ashkali një (1) vend; komunitetit Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian, i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit Boshnjak tri (3) vende, komunitetit Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend. Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, do të jetë vend shtesë, përveç dhjetë (10) vendeve të rezervuara që u ndahen përkatësisht komunitetit Serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, mandati ekzistues në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të konsiderohet si mandati i parë zgjedhor i Kuvendit, në rast se ky mandate zgjat për së paku dy vite nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

58. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 148 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

X. Amendamenti 10 i propozuar

59. Amendamenti 10 propozon që neni 149 i Kushtetutës të fshihet.

60. Neni 149 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 149 [Miratimi Fillestar i Ligjeve me Interes Vital]

Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 81 të kësaj Kushtetute, ligjet me interes vital të radhitura në atë nen, do të miratohen fillimisht me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm të Kuvendit dhe që votojnë.

61. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 149 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XI. Amendamenti 11 i propozuar

62. Amendamenti 11 propozon që neni 150 i Kushtetutës të fshihet.

63. Neni 150 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 150 [Procesi i Emërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve]

1. Shqyrtimi gjithëpërfshirës mbarëkosovar për përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërim të përhershme për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë, deri në moshën e pensionimit të përcaktuar me ligj, do të vazhdojë të bëhet në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/2 dhe nuk do të ndikohet nga përfundimi i mandatit të UNMIK-ut, ose nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute.

2. Të gjithë kandidatët e suksesshëm, të cilët janë emëruar ose riemëruar për gjyqtarë dhe prokurorë nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në postet e tyre deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre, ose deri atëherë kur ata të shkarkohen në pajtim me ligjin.

3. Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial do t'i paraqesë me shkrim Këshillit Gjyqësor të Kosovës rekomandimet për kandidatët për emërimin dhe riemërimin e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë, i cili ushtron pushtetin përfundimtar, që t'ia propozojë Presidentit të Kosovës kandidatët për emërim dhe riemërim si gjyqtarë dhe prokurorë.

4. Të gjithë kandidatët e suksesshëm, të cilët janë emëruar ose riemëruar nga Presidenti I Kosovës si gjyqtarë dhe prokurorë, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në këto poste deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre, ose deri atëherë kur ata të shkarkohen në pajtim me ligjin.

5. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 105 të kësaj Kushtetute, mandati i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve që në mënyrë të suksesshme e kalojnë procesin e emërimit siç është përcaktuar në këtë nen dhe të cilët kanë ushtruar funksionin së paku dy vjet para emërimit, sipas këtij neni, është i përhershëm deri në moshën e pensionimit sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohen në pajtim me ligjin.

64. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 150 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XII. Amendamenti 12 i propozuar

65. Amendamenti 12 propozon që neni 151 i Kushtetutës të fshihet.
66. Neni 151 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 151 [Përbërja e Përkohshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të përbëhet siç vijon:

1. Pesë (5) anëtarë janë anëtarë kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, që janë verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, si pjesë e fazës së parë dhe të dytë të procesit të emërimit, në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/02. Prej këtyre pesë (5) anëtarëve, një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të zgjedhur sipas metodës së rastësisë, do të shërbejnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës deri në skadimin e natyrshëm të mandateve të tyre ekzistuese, kur do të zëvendësohen me një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial dhe që janë zgjedhur nga ana e kolegëve të tyre, duke iu përmbajtur metodave që kanë për qëllim sigurimin e përfaqësimit sa më të gjerë të shërbimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë. Dy (2) gjyqtarët e mbetur dhe një (1) prokuror nga radhët e pesë (5) anëtarëve kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, do të shërbejnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës për një mandat plotësues njëvjeçar pas skadimit të natyrshëm të mandatit të tyre, kur ata do të zëvendësohen me procedurë të njëjtë sikur edhe ish-kolegët e tyre të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Në rast të themelimit të një subjekti përgjegjës për çështjet e emërimit, disiplinës dhe shkarkimit të prokurorëve, të gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të jenë gjyqtarë.

2. Tetë (8) anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës në mënyrën e përcaktuar me këtë Kushtetutë, përveç dy (2) nga katër (4) anëtarët e zgjedhur nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, duhet të jenë ndërkombëtarë, të përzgjedhur nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, sipas propozimit të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Njëri nga anëtarët ndërkombëtarë duhet të jetë gjyqtar.

67. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 151 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XIII. Amendamenti 13 i propozuar

68. Amendamenti 13 propozon që neni 152 i Kushtetutës të fshihet.

69. Neni 152 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata kushtetuese do të përbëhet si në vijim:

1. Gjashtë (6) nga nëntë (9) gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit.

2. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, dy (2) do të shërbejnë për një mandat trevjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe dy (2) do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes. Mandatet e gjyqtarëve fillestarë do të zgjidhen me short, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, menjëherë pas emërimit të tyre.

3. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, katër (4) do të zgjidhen votat e dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë. Dy (2) do të zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

4. Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre (3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.

5. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikur është e parashikuar me Kushtetutë.

70. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 152 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XIV. Amendamenti 14 i propozuar

71. Amendamenti 14 propozon që neni 153 i Kushtetutës të fshihet.

72. Neni 153 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 153 [Prania Ndërkombëtare Ushtarake]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute, Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara nga instrumentet relevante ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007. Kryesuesi i Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti final në zonën operative për sa i përket interpretimit të atyre aspekteve të marrëveshjes së përmendur që i referohen Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdikcion të rishikojë, të pakësoj ose përndryshe të kufizoj mandatin, kompetencat dhe detyrimet e referuara në këtë nen.

73. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 153 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XV. Amendamenti 15 i propozuar

74. Amendamenti 15 propozon që neni 154 i Kushtetutës të fshihet.

75. Neni 154 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 154 [Trupat e Mbrojtjes të Kosovës]

Trupat e Mbrojtjes të Kosovës do të shpërbëhen brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Deri në shpërbërje, Prania Ndërkombëtare Ushtarake, në konsultim me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil dhe Republikën e Kosovës do të ketë autoritet ekzekutiv mbi Trupat e Mbrojtjes të Kosovës dhe vendos për dinamikën kohore të shpërndarjes.

76. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 154 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XVI. Amendamenti 16 i propozuar

77. Amendamenti 16 propozon që neni 155 (Shtetësia) i Kushtetutës të bartet tek Kapitulli I – Dispozitat Themelore.

78. Neni 155 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 155 [Shtetësia]

1. Të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në datën e miratimit të kësaj Kushtetute, gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës ua njeh të drejtën në shtetësinë e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe shtetësia që ata kanë, të gjithë qytetarëve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës me datën 1 janar 1998, dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë.

79. Gjykata konsideron se bartja e propozuar e nenit 154 të Kushtetutës tek Kapitulli I (Dispozitat Themelore) nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XVII. Amendamenti 17 i propozuar

80. Amendamenti 17 propozon që neni 156 (Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit) të fshihet.
81. Neni 156 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit]

Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.

82. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 156 të Kushtetutës do të mund të pakësonte disa të drejta dhe liri të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
83. Në të vërtetë, me nenin 22 të Kushtetutës miratohen disa konventa ndërkombëtare duke u thirrur në to. Në një pjesë të nenit posaçërisht përcaktohet:

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

84. Nenet 13 dhe 14 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) posaçërisht përcaktojnë si vijon:

Neni 13 i DUDNJ-së

“(1) Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti.

(2) Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet”.

Neni 14

“(1) Gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzojë në vende të tjera azil nga ndjekjet.

(2) Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara”.

85. Ngjashëm, neni 2 i Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) garanton lirinë e lëvizjes. Ai thotë si vijon:

Neni 2 i Protokollit Nr. 4 të KEDNJ-së

“Liria e lëvizjes

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.
 2. Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.
 3. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.
 4. Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t’u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike.
86. Pa nenin 156, detyrimi pozitiv që ka Republika e Kosovës për t’i zbatuar të drejtat e njeriut të garantuara me nenet 13 dhe 14 të DUDNJ-së do të mund të pakësohej së tepërmi. Pa mbështetjen pozitive të Qeverisë, siç kërkohet tani me nenin 156 të Kushtetutës, garantimi i të drejtës së njeriut për liri të lëvizjes, të përcaktuar, ndër të tjera, në DUDNJ dhe KEDNJ, kjo e drejtë lehtë do të mund të injorohej apo pakësohej.
87. Kjo do të ishte në kundërshtim me nenin 1 të KEDNJ-së, i cili i obligon shtetet t’ia “sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente”.
88. Neni 35 i Kushtetutës ua garanton shtetasve dhe të huajve të drejtën për lëvizje të lirë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës. Ai posaçërisht përcakton:

“Neni 35 [Liria e Lëvizjes]

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.
 2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.
 3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t’u ndalohej hyrja në Republikën e Kosovës.”
89. Neni 156 vë obligim pozitiv në Republikën e Kosovës për t’u ndihmuar refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit në ushtrimin e të drejtave të tyre për lëvizje të lirë. Pa këtë mandat kushtetues për Republikën e Kosovës që pozitivisht t’u ndihmojë atyre personave në ushtrimin e asaj të drejte, ata mund të mos jenë në gjendje ta ushtrojnë atë të drejtë.

90. Neni 46 i Kushtetutës garanton që askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Ai përcakton:

“Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.”

91. Gjykata rikujton që mbrojtja e pronës garantohet edhe me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, i cili thotë:

“Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij.

Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

92. Neni 156 vë barrë pozitive në Republikën e Kosovës për t’u ndihmuar refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit në ushtrimin e të drejtave të tyre për të mos u privuar në mënyrë arbitrare nga prona. Pa këtë mandat kushtetues për Republikën e Kosovës që pozitivisht t’u ndihmojë atyre personave në ushtrimin e asaj të drejte, ata mund të mos jenë në gjendje ta ushtrojnë atë të drejtë.
93. Për të gjitha këto arsye, Gjykata konfirmon se amendamenti 17 i propozuar duket të pakësojë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, siç u cek më lartë.

XVIII. Amendamenti 18 i propozuar

94. Amendamenti 18 propozon që neni 157 i Kushtetutës të fshihet.
95. Neni 157 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 157 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Revizori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës do të jetë një ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil.

96. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 157 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XIX. Amendamenti 19 i propozuar

97. Amendamenti 19 propozon që neni 158 i Kushtetutës të fshihet.
98. Neni 158 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 158 [Autoriteti Qendror Bankar]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës do të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas marrjes së pëlqimit nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil.

99. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 158 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XX. Amendamenti 20 i propozuar

100. Amendamenti 20 propozon që neni 159 i Kushtetutës të fshihet.
101. Neni 159 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 159 [Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore]

1. Të gjitha ndërmarrjet që ishin në tërësi ose pjesërisht në pronësi shoqërore, para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të privatizohen në pajtim me ligj.

2. Të gjitha interesat në pronësi shoqërore në prona dhe ndërmarrje në Kosovë do të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës.

102. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 159 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XXI. Amendamenti 21 i propozuar

103. Amendamenti 21 propozon që neni 160 i Kushtetutës të fshihet.

104. Neni 160 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 160 [Ndërmarrjet në Pronësi Publike]

1. Republika e Kosovës do t'i ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet në Republikën e Kosovës që janë ndërmarrje në pronësi publike. Të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore do të jenë obligime të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës mund të privatizojë, të japë me koncesion ose të japë me qira ndërmarrjet në pronësi publike në mënyrën e rregulluar me ligj.

2. Të drejtat e pronësisë, që kanë të bëjnë me një ndërmarrje në pronësi publike e cila ofron shërbime vetëm në një komunë specifike ose në një numër të kufizuar të komunave, do të jenë të drejta pronësore të komunës ose komunave përkatëse. Obligimet në lidhje me të drejtat e tilla pronësore do të jenë obligime të komunës ose komunave përkatëse. Kuvendi mundet me ligj të identifikojë një ndërmarrje të tillë dhe komunën a komunitat, që kanë të drejta pronësore dhe obligimet lidhur me to. Nëse përcaktohet me ligj, komuna a komunitat përkatëse, ndërmarrjet në pronësi shoqërore mund t'i privatizojnë, t'i japin me koncesion ose t'i lëshojnë me qira.

105. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 160 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XXII. Amendamenti 22 i propozuar

106. Amendamenti 22 propozon që neni 161 i Kushtetutës të fshihet dhe të shtohet një nen i ri, si vijon.

“Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre në institucionet ku janë deri në fund të mandatit të specifikuar. Kosova do t'ua japë këtyre individëve të njëjtat privilegje dhe imunitete që i gëzojnë diplomatët dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike.”

107. Neni 161 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 161 [Transicioni i Institucioneve]

1. Me përjashtim të rastet kur Kushtetuta përcakton një transicion tjetër, të gjitha kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrimet e institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë, do t'u kalojnë menjëherë atyre institucioneve në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Kohëzgjatja e mandatit të secilit institucion para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të mbetet e paprekur dhe e pandryshuar deri në skadimin e rregullt, ose deri në zgjedhjet e reja.

2. Deri në zgjedhjet e para parlamentare pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, Kryesia e Kuvendit mbetet me kompetencat e parapara në mandatin e saj ekzistues. Pas seancës konstituive të Kuvendit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, Kryesia e Kuvendit ristrukturohet në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.

3. Dispozitat e nenit 70.3.(3) nuk do të aplikohen deri në seancën konstituive të Kuvendit pas zgjedhjeve të para parlamentare pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

4. Deri në formimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, funksionet dhe përgjegjësitë e tij do të i kryejë Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

108. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 161 të Kushtetutës dhe zëvendësimi i tij me një nen të ri nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.


PËR KËTO ARSYE, NË BAZË TË NENIT 113.9 TË KUSHTETUTËS, GJYKATA NJËZËRI VENDOSI SI VIJON :

- I. Kërkesa që përmban Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012, është e pranueshme;
- II. Gjykata konfirmon që prej 22 amendamenteve të përfshira në Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012, vetëm amendamenti 17 duket të pakësojë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës;
- III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani